



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

	REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU	
Nrfaq/Br.str. 169		
Data/Datum 27.09.2018		
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE FUSHË-KOSOVË		

Datë: 27.09.2018

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 26.09.2018, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 294, të datës 05.09.2018, paraqitur nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (b), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (c), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Buxhetit të Planifikuar të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2019

1. Për aprovimin e Buxhetit të Planifikuar të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2019, në shumë të përgjithshme prej 11,097,733.00€, i shpërndarë nëpër programe e nënprograme të kategorive ekonomike si vijon:
 - 1.1 Për paga dhe mëditje për 742 të punësuar në Administratën Komunale, Arsimit dhe Shëndetësi, buxheti i komunës është në shumë prej: 4,848,709.00€;
 - 1.2 Për mallra dhe shërbime, buxheti i komunës është në shumë prej: 1,301,707.00€;
 - 1.3 Për shpenzime komunale, buxheti i komunës është në shumë prej: 200,000.00€;
 - 1.4 Për subvencione e transfere, buxheti i komunës është në shumë prej: 294,657.00€;
 - 1.5 Për shpenzime në projekte kapitale, buxheti i komunës është në shumë prej: 4,452,660.00€.
2. Vlerësimet e hershme të caktuara me kufijtë për Buxhetet e Planifikuara me Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitin fiskal 2020, është në shumë të përgjithshme prej: 11,466,733.00€, me shumën e caktuar për projekte kapitale prej: 4,821,660.00€ dhe për vitin fiskal 2021, është në shumë të përgjithshme prej: 11,857,034.00€, me shumën e caktuar për projekte kapitale prej: 5,187,717.00€.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera, për zbatimin e këtij vendimi, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorive Komunale dhe Arkivës.


Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



Datë: 02.10.2018

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 26.09.2018 dhe vazhdimin e saj më datë 28.09.2018, pas shqyrtimit të propozimit Nr. 1363, të datës 25.09.2016, paraqitur nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, mbështetur në kërkesën Nr. 1340, të datës 14.09.2018, e parashtruar nga 'KARITAS - Kosova', bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (ç), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për lejimin e mjeteve financiare për lidhjen e Aneks-marrëveshjes për realizimin e projektit 'Ngritja e përkujdesit social dhe shëndetësor në komunën e Fushë-Kosovës', në bashkëpunim dhe bashkëfinancim me 'KARITAS - Kosova' për vitin 2018'

1. Aprovohet propozimi Nr. 1363, i datës 25.09.2018, për realizimin e projektit 'Ngritja e përkujdesit social dhe shëndetësor në Komunën e Fushë-Kosovës', në bashkëpunim dhe bashkëfinancim me 'KARITAS - Kosova' për vitin 2018', në shumë të përgjithshme prej 22,685.51€.
2. Lejohen mjetet financiare nga buxheti i komunës, në shumë prej 21,139.20€, për lidhjen e Aneks-marrëveshjes për realizimin e projektit sipas pikës një (1) të vendimit, nga kodi ekonomik i projektit Nr. 44684, bashkëfinancim i projekteve, programi Nr. 17502.
3. Për realizimin e projektit, sipas pikës një (1) të vendimit, 'KARITAS - Kosova', financohet me mjete financiare, në shumë prej 1,546.31€€.
4. Me realizimin e këtij projekti të punësimit në bashkëfinancim me 'KARITAS - Kosova' për vitin 2018, për qëllim të punësuarve mbetet në favor të arsimit e shëndetësisë dhe ndihmohen qytetarët e Komunës së Fushë-Kosovës në ofrimin e shërbimeve për përmirësimin e kushteve të jetesës:
 - 4.1 Shërbimet sociale edukative dhe shëndetësore për përmirësimin e kushteve të varfërisë për shtresat sociale;
 - 4.2 Vazhdimin e përkrahjes financiare të punësimit të qytetarëve të komunës tonë - punëtorë në veprimtari të ndryshme sociale dhe edukative;
 - 4.3 Parandalimi i procesit të migrimit ilegal nëpërmjet krijimit të vendeve të punës;
 - 4.4 Përkujdesje sociale dhe shëndetësore për familjet e komuniteteve: rom, ashkalinj dhe egjiptas.

5. Kryerja e procedurave tjera, lidhja e Aneks-marrëveshjes së bashkëpunimit dhe bashkëfinancimit me 'KARITAS - Kosova' dhe sigurimi i mjeteve financiare nga buxheti i komunës, sipas pikës (2) të vendimit, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit dhe Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.
6. Për rezultatet e arritura në punë përmes punësimit me këtë projekt të përbashkët të bashkëpunimit dhe bashkëfinancimit ndërmjet Komunës së Fushë-Kosovës dhe 'KARITAS - Kosova', si bashkërealizues në realizimin e projektit të punësimit informohet me shkrim Kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës.
7. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës,
Drejtorisë së FB, Drejtorisë së SHMS, Drejtorisë së ADM, Drejtorisë
së ARSIMIT, Drejtorisë së SHPM dhe Arkivit.**

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA	
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE	
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU	
Nr.faq/Br.str.	181
Data/Datum.	10.10.2018
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE	

Datë: 05.10.2018

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 26.09.2018, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 760, të datës 13.09.2018, paraqitur për shqyrtim nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit dhe i shqyrtuar në mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c, l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (ç, nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 25, nenin 27, paragrafi 2, të Rregullores për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale Nr. 125, të datës 25.09.2014, mori:

V E N D I M

Për aprovimin e buxhetit të shpenzuar në Komunën e Fushë-Kosovës për periudhën janar-qershor 2018

1. Për aprovimin e buxhetit të shpenzuar në Komunën e Fushë-Kosovës, për periudhën janar-qershor 2018, në shumë të përgjithshme prej 3,685,815.27€.
2. Buxheti i shpenzuar sipas programeve është si vijon:
 - 2.1 Në administratën komunale buxheti i shpenzuar është në shumë prej 1,528,297.29€;
 - 2.2 Në arsim buxheti i shpenzuar është në shumë prej 1,578,215.11€;
 - 2.3 Në shëndetësi dhe Qendrën për Punë Sociale buxheti i shpenzuar është në shumë prej 563,415.81€;
 - 2.4 Në Zyrën e Komuniteteve buxheti i shpenzuar është në shumë prej 15,887.06€.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave dhe Buxhetit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB-së dhe Arkivit.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



	REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU	
Nr.faq/Br.str.	182	
Datë/Datum.	10.10.2018	
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE		

Datë: 05.10.2018

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 26.09.2018, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 759, të datës 13.05.2018, paraqitur nga Koordinatorja e Njësitit për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore dhe i shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (q), nenin 27, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin në parim të Projekt-Planit të Veprimit për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Komunën e Fushë-Kosovës për periudhën 2019-2023 dhe dërgimin e tij në procedurën e diskutimit publik

1. Për aprovimin në parim të Projekt-Planit të Veprimit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve përmes qeverisë komunale për të krijuar ambient miqësor për fëmijët në Komunën e Fushë-Kosovës për periudhën 2019-2023 dhe dërgimin e tij në procedurën e diskutimit publik.
2. Drejtoria e Arsimit, Drejtoria e Shëndetësisë e Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit si dhe Drejtoritë tjera të Komunës, do të ofrojnë informata e sqarime të nevojshme për opinionin publik lidhur me këtë Plan të Veprimit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, në diskutimin publik.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës, Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Arsimit, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, Drejtoritë tjera të Komunës, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe Njësi për të Drejtat e Njeriut.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.


Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së ADM, Drejtorisë së Arsimit, Drejtorisë së KRS, Drejtorisë së SHMS, Drejtorisë së FB, ZKKK, NJDNJ dhe Arkivit.

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha**



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



Datë: 08.10.2018

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 26.09.2018 dhe vazhdimin e saj më datë 28.09.2018, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 1334, të datës 13.09.2016, paraqitur nga Kryetari i Komunës dhe i shqyrtuar në mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 17, nenin 40, nenin 51, paragrafi 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, nenin 27, nenin 34, paragrafi 34.2, nenin 40, paragrafi 40.1, shkronja (dh), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për themelimin e Komitetit për Persona me nevoja të veçanta në Komunën e Fushë-Kosovës

1. Për themelimin e 'Komitetit për Persona me nevoja të veçanta në Komunën e Fushë-Kosovës', në përbërje prej shtatë (7) anëtarëve, si vijon:
 - 1.1 Miranda Shabani - përfaqësuese e LDK-së në Kuvendin e Komunës, anëtare;
 - 1.2 Eglantina Azemi - përfaqësuese e Lëvizjes Vetëvendosje në Kuvendin e Komunës, anëtare;
 - 1.3 Aida Alimi - përfaqësuese e PDK-së në Kuvendin e Komunës, anëtare;
 - 1.4 Bashkim Krasniqi - përfaqësues i Partisë Liberale Egjiptiane nga radhët e komuniteteve në Kuvendin e Komunës, anëtar;
 - 1.5 Agim Jashari - përfaqësues nga Organizata OPFAKOS, anëtar;
 - 1.6 Ujup Rashica - përfaqësuese i Shoqatës së të Verbërve, anëtar;
 - 1.7 Maliq Thaçi - përfaqësues i Organizatës Kryqi i Kuq - Dega në Fushë-Kosovë, anëtar.
2. Komiteti për Persona me nevoja të veçanta në Komunën e Fushë-Kosovës është përgjegjës dhe kompetent që të ofrojë ndihmë profesionale dhe të jap rekomandime për Ekzekutivin e Komunës dhe Kuvendin e Komunës, lidhur me gjithëpërfshirjen e këtyre kategorive me nevoja të veçanta në: fushën e arsimit, shëndetësisë, mirëqenies sociale, urbanizmit dhe infrastrukturës.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Anëtarëve të Komitetit për Persona me Nevoja të Veçanta, Drejtorive të Komunës dhe Arkivit.

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha**

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU

Nr.faq/Br.str. 184
Datë/Datum. 10.10.2018
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE



REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 08.10.2018

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 26.09.2018 dhe vazhdimin e saj më datë 28.09.2018, pas shqyrtimit të propozimit Nr. 155, të datës 13.09.2016, paraqitur nga Kryesuesja e Kuvendit të Komunës dhe i shqyrtuar në mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (e), nenin 51, paragrafi 51.1, nenin 53, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 4, paragrafi 1 dhe 2, nenin 8, nenin 9, nenin 10, nenin 13, të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2014, për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të Përhershme në Komunë, nenin 27, shkronja (e), nenin 34, paragrafi 34.1, shkronja (b), nenin 36, nenin 38, të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për ndryshimin e vendimit Nr. 63, të datës 06.04.2018, për zëvendësimin e përfaqësueses së komunitetit malazez në përbërjen e Komitetit për Komunitete

1. Për ndryshimin e vendimit Nr. 63, të datës 06.04.2018, paragrafi 1, nënparagrafi 1.9, lidhur me përbërjen e Komitetit për Komunitete dhe zëvendësimin e përfaqësueses së deritanishme të komunitetit malazez znj. Snezhana Karadzic, me përfaqësuesen e re të komunitetit malazez, znj. Milica Filipovic.
2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Anëtares së Komitetit për Komunitete, Drejtorisë së FB, Udhëheqëses së Personelit dhe Arkivit.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha

[Signature]



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU

Mr./aq./Br. str. 185
Datë/Datum. 10.10.2018
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 08.10.2018

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 26.09.2018 dhe vazhdimin e saj më datë 28.09.2018, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 1367, të datës 25.09.2016, paraqitur nga Kryetari i Komunës, mbështetur në kërkesën e Shoqatës së Invalidëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, bazuar në nenin 11, nenin 17, shkronja (s), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (n), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Propozimit për caktimin lokacionit për vendosjen e shtatores së Komandantit Legjendar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës Adem Jashari në oborrin e shkollës 'Selman Riza' në hapësirën e parkut në Fushë-Kosovë

1. Për aprovimin e Propozimit për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së Komandantit Legjendar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës Adem Jashari, në oborrin e Shkollës Filllore të Mesme të Ulët 'Selman Riza' në hapësirën e parkut, e evidentuar në certifikatën e pronës me numër të njësisë kadastrale P - 72514036-00793-1 në Fushë-Kosovë.
2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së Arsimit, Drejtorisë së GJKP, Shoqatës së Invalidëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe Arkivit.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha

[Signature]



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



	REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU	
Nr. lag/B.r. str.		186
Datë/Datum.		10.10.2018
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE		

Datë: 08.10.2018

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 26.09.2018 dhe vazhdimin e saj më datë 28.09.2018, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 1333, të datës 13.09.2016, paraqitur nga Kryetari i Komunës dhe i shqyrtuar në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Propozimit për shprehjen e interesit të përgjithshëm për blerjen e pronës për varreza në fshatin Miradi e Epërme

3. Për aprovimin e Propozimit për fillimin e procedurave për shprehjen e interesit të përgjithshëm për blerjen e pronës për varreza në fshatin Miradi e Epërme me financim nga buxheti i komunës dhe me një participim nga subjektet afariste dhe komuniteti.
4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për blerjen e pronës për shërbime me interes të përgjithshëm për qytetar është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit, Drejtorisë së Planifikimit Urban, Drejtorisë së Gjeodezisë, Kadastrit e Pronës, Drejtorisë së Shërbimeve Publike e Mjedisit dhe Zyrës së Prokurimit.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorisë së PU, Drejtorisë së GJKP, Drejtorisë së SHPM, Zyrës së Prokurimit dhe Arkivit.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës


Vjollca Konjusha





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 08.10.2018

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 26.09.2018 dhe vazhdimin e saj më datë 28.09.2018, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 1333, të datës 13.09.2016, paraqitur nga Kryetari i Komunës dhe i shqyrtuar në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për formimin e Komisionit për vlerësimin e ofertave për blerjen e pronës për varreza në fshatin Miradi e Epërme

1. Për formimin e 'Komisionit për vlerësimin e ofertave për blerjen e pronës për varreza në fshatin Miradi e Epërme' nga procedura e shprehjes së interesit të përgjithshëm për blerjen e pronës me financim nga buxheti i komunës dhe me një participim nga subjektet afariste dhe komuniteti në përbërjen prej pesë anëtarëve, si vijon:
 - 1.1 Arjeta Jashari - përfaqësuese e LDK-së në Kuvendin e Komunës, anëtare;
 - 1.2 Doruntina Jashari - përfaqësuese e Lëvizjes Vetëvendosje në Kuvendin e Komunës, anëtare;
 - 1.3 Ali Ismaili - përfaqësues i Partisë së Drejtësisë në Kuvendin e Komunës, anëtar;
 - 1.4 Hasan Gjyrevci - Shef për Kuvend dhe Komitete, anëtar;
 - 1.5 Bardhyl Koiçiçi - Shef për Planifikimin e Buxhetit, anëtar.
2. Në cilësinë e vëzhguesit pjesëmarrës do të jenë edhe përfaqësuesit e fshatit Miradi e Epërme si vijon: Haqif Kllokoqi, Milaim Berjani, Nazmi Reçica, Shefki Veseli dhe Rizah Breznica.
3. Kryerja e procedurave për hapjen dhe vlerësimin e ofertave është në kompetencë të anëtarëve të Komisionit të cekur në pikën një të vendimit dhe për punën e tij i raporton Kuvendit të Komunës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Anëtarëve të Komisionit, Zyrës së Prokurimit dhe Arkivit.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha